



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS ZUBIN POTOKUT

Numri i lëndës: 2022:066578

Datë: 30.08.2024

Numri i dokumentit: 06105729

P.nr.58/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA ZUBIN POTOK –Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Penal, Gjyqtarja e vetme gjykuese Marigona Lajqi, me bashkëpunëtoren profesionale, Kaltrina Sfarqa, në lëndën penale ndaj të pandehurve: M.L.dhe M.D., për shkak të veprës penale: *Lëndim i rëndë trupor, nga neni 186, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës*, duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm PP.II.446/2022, të datës 20.10.2022, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit fillestar me datë 31.07.2024, në prezencë të prokurorit të shtetit A.Xh., i pandehuri M.L.me mbrojtësin e tij sipas detyrës zyrtare Av.L.A., i pandehuri M.D. me mbrojtësin e tij Av.Xh.H., i dëmtuari N.R., si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar Av.L. P., me datë 01.08.2024 shpalli publikisht, ndërsa me datë 30.08.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Të pandehurit:

1.M.L., nga i ati D..., e ëma J..., e vajzërisë V..., i lindur me datë ..., me vendbanim në Z...P..., me numër personal të identifikimit ..., serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

2. M... D., nga i ati S..., e ëma M..., e vajzërisë V..., i lindur me datë, me vendbanim në Z....P....., me numër personal të identifikimit, serb, shtetas i Republikës së Kosovës.

JANË FAJTOR

SEPSE:

Me, rreth orës, në Z...P..., përballë kafenesë "....", me dashje i kanë shkaktuar lëndime të rënda trupore një tjetri - të dëmtuarit R.N., në atë mënyrë që derisa i dëmtuari ka qenë duke lëvizur para lokalit të kafesë në drejtim të dyqanit të ushqimeve të shpejta, që ndodhet përballë

lokalit të kafesë, i është afruar viktimës, mes të pandehurit të parë L.M.dhe viktimës ka pasur një debat verbal, gjatë të cilit L... i ka thënë N... se nuk guxon të kalojë, se nuk guxon t'i shikojë, se është "mangash" dhe nëse do mund ta thyejë, kështu që meqenëse i dëmtuari N..., duke mos dashur konflikt, u përgjigj se nuk ka pasur nevojë për këtë, L... e ka kapur këmbishën e të dëmtuarit në zonë, e ka fiksuar në makinën e parkuar aty dhe më pas i pandehuri i dytë D... M... e ka goditur me grusht në kokë, sipër veshit të majtë, pa ndonjë arsye të dukshme, duke e bërë N... të lëkundet, filluan të bien, por u mbajtën disi pas automjetit, dhe të pandehurit L. dhe D.vazhduan ta godasin dhe e goditën me grushte në pjesën e kokës u krijua një turmë nga njerëzit që ishin larguar nga klubi dhe në atë turmë të pandehurit vazhduan ta godasin viktimën dhe kur turma u duk se u qetësua për një moment, të pandehurit e sulmuan sërish viktimën N. duke e goditur me grushte në kokë dhe i shkaktuan lëndime në formë të mavijosjes së indeve të buta e kokës dhe trupit, ënjtje e indeve të buta me mpiksje nënlëkurore të gjakut, gjak në zonën e mollëzave në të dy anët e fytyrës dhe rreth të dy syve, mavijosje e bebëzës së syrit të djathtë të fytyrës, fraktura të shumta të kockës së hundës së syrit të djathtë (shtratit) dhe tronditje të trurit, të cilat paraqesin lëndime të rënda trupore.

-Me këtë kanë kryer veprën penale: Lëndim i rëndë trupor, nga neni 186, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

Andaj, Gjykata, në bazë të nenit 1, 4, 7, 17, 21, 38, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70, si dhe 186 paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së, dhe nenit 358, 364, 449, 450 dhe 459, të KPP-së, u:

S H Q I P T O N

- I. Të pandehurit M.L. DËNIM ME BURGIM të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.
- II. Të pandehurit M.D. DËNIM ME BURGIM të kushtëzuar në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër tjetër penale gjatë periudhës së verifikimit, në kohëzgjatje prej 2 (dy) vite, nga plotfuqishmëria e këtij Aktgjykimi.

- III. Obligohen të pandehurit, që t'i paguajnë shpenzimet e procedurës gjyqësore, secili veç e veç, në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20€ (njëzet euro), po ashtu edhe në emër të taksës për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20€ (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.
- IV. Pala e dëmtuar N.R., ka hequr dorë nga kërkesa pasurore juridike.

A R S Y E T I M

Aktakuza

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.446/2022, të datës 20.10.2022, ndaj të pandehurve: M.L.dhe M.D., për shkak të veprës penale: *Lëndim i rëndë trupor, nga neni 186, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.*

Rrjedha e procedurës

Gjykata, me datë 31.07.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në praninë e prokurorit të shtetit A.Xh., të pandehurit Milanovic Luke, mbrojtësit Av.Leotrim Ademi, të pandehurit Milovic Dusan, mbrojtësit Av.Xh.H., të dëmtuarit N.R., përfaqësuesit të palës së dëmtuar Av.L.P.

Të pandehurit, gjatë seancës së shqyrtimit fillestar, pas njoftimit nga gjykata me të drejtat e tyre në këtë fazë të procedurës penale dhe leximit të aktakuzës, kanë pranuar fajësinë në tërësi për veprën penale sipas aktit akuzues.

Gjykata ka marrë mendimin e prokurorit të shtetit, mbrojtësve të të pandehurve dhe përfaqësuesit të palës së dëmtuar, mbi pranimin e fajësisë.

Prokurori i Shtetit A.Xh., i propozoi gjykatës që të miratoj pranimin e fajësisë, pasi është dhënë në mënyrë vullnetare, konform dispozitave të nenit 242 të KPP-së dhe ka mbështetje në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Mbrojtësi i të pandehurit L.M., Av.L.A., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar se meqenëse janë plotësuar kushtet ligjore dhe ekziston vullneti i prokurorisë, i ka propozuar gjykatës që të pranojë pranimin e fajësisë nga i pandehuri L.M.c.

Mbrojtësi i të pandehurit D. M., Av.Xh.H., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar se e mbështet pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit D.M.. Gjykatës i ka propozuar që të merr aktvendim mbi pranimin e fajësisë, duke pasur parasysh se pranimi i tillë i fajësisë gjendet edhe në provat e shkresave të lëndës.

Përfaqësuesi i palës së dëmtuar Av.L.P., lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve, ka deklaruar se janë plotësuar kushtet ligjore që gjykata të pranojë pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurve.

Gjetjet e Gjykatës

Gjykata ka shqyrtuar pranimin e fajësisë të cilin e kanë deklaruar të pandehurit Milanovic Luke dhe M.D., në mbështetje të nenit 242 të KPP-së, ka vlerësuar se janë përmbushur kushtet ligjore për miratimin e pranimit të fajësisë për të pandehurit. Gjykata gjen se pranimi i fajësisë nga të pandehurit mbështetet në tërësi në provat që përmban kjo akuzë, siç janë: Memorandumi zyrtar i datës 28.04.2022, Procesverbal i marrjes në pyetje të pandehurit M.L. i datës 28.04.2022, Procesverbal i marrjes në pyetje të pandehurit M.D. i datës 28.04.2022, Memorandum zyrtar i datës 14.04.2022, Procesverbal i dëgjimit të dëmtuarit i datës 07.04.2022, Raporti specialistik për Ninoslav Radosavljevic i datës 17.02.2022, Memorandum zyrtar i datës 17.05.2022, Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit R.J. i datës 12.05.2022, Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit J.F. i datës 12.05.2022, Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit V.V., i datës 13.05.2022, Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit I.J. i datës 16.05.2022.

Gjykata gjen se pranimi i fajësisë është bërë nga të pandehurit në mënyrë vullnetare, pasi që kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë. Gjykata i'a kishte tërheq vërejtjen të pandehurve se pas pranimit të fajësisë nuk mund të shfrytëzojnë të drejtën në ankesë, lidhur me bazën për gjendjen faktike, i njëjti është njoftuar se nëse e pranon fajësinë humbë mundësinë e kundërshtimit të provave në aktakuzë dhe mundësinë për paraqitjen e provave tjera, si dhe për faktin se pranimi i fajësisë sipas ligjit është një rrethanë lehtësuese që me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit gjykata mund të shqiptoj një dënim më të butë. Gjykata gjithashtu ka vërtetuar se aktakuza në këtë rast nuk përmban asnjë shkelje ligjore e as ndonjë gabim faktik dhe nuk ka bazë për hedhjen e akuzës.

Gjykata bazuar në pranimin e fajësisë nga të pandehurit dhe mbi bazën e provave të cekura si më lartë, përtej çdo dyshimi ka vërtetuar se të pandehurit Milanovic Luke dhe Milovic Dusan janë përgjegjës për veprën penale për të cilën akuzohen: *Lëndim i rëndë trupor, nga neni 186, paragrafi 1, pika 1.3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së*, për të cilën veprën penale është paraparë dënimi me burgim prej gjashtë (6) muaj deri në pesë (5) vjet.

Matja e llojit dhe lartësisë së dënimit:

Gjykata, lidhur me caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurit, ka vlerësuar rrethanat për matjen e dënimit në mbështetje të nenit 69 të KPRK-së, e si rrethanë rënduese, gjykata ka vlerësuar shkallën e përgjegjësisë penale, dashjen e të pandehurve, përgjegjësinë dhe përgjegjshmërinë e plotë, kontributin esencial të tyre në këtë veprën penale, rrethana të tjera rënduese nuk ka gjetur.

Ndërsa si rrethanë lehtësuese, ka marrë për bazë faktin se të pandehurit kanë treguar sjellje të mira, kanë bashkëpunuar plotësisht me organet e rendit dhe drejtësisë që nga fillimi i procedurës kundër tij, duke kontribuar kështu në zbardhjen e shpejtë dhe të plotë të këtij rasti, keqardhjen e shprehur para gjykatës për rastin e ndodhur, faktin se ishin pajtuar me të dëmtuarin. Gjykata po ashtu si rrethanë lehtësuese mori parasysh se nga verifikimi mbi të kaluarën penale rezulton se është hera e parë që të akuzuarit kanë rënë ndesh me ligjin. Ndërsa, si rrethanë posaçërisht lehtësuese për të pandehurit është vlerësuar pranimi i fajësisë në tërësi për veprën penale që në hapje të shqyrtimit fillestar të çështjes.

Duke marrë parasysh të gjitha këto rrethana si dhe shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, gjykata vlerëson se, dënimi i shqiptuar, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Po ashtu, gjykata vlerëson se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, që t'i parandaloj kryerësit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tyre, si dhe të parandaloj personat tjerë nga kryerja e veprave penale si dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Shpenzimet procedurale:

Vendimin për shpenzimet e procedurës gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 të KPP-së, që kanë të bëjnë me shpenzimet e procedurës dhe ato për paushall gjyqësor. Ndërsa taksa për

kompensimin viktimave të krimit, në kuptim të nenit 39 par. 3 të Ligjit nr. 05/L-036 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Kërkesa pasurore juridike:

Lidhur me kërkesën pasurore juridike, gjykata ka vendosur si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit, në pajtim me nenin 459 të KPP-së, duke e udhëzuar palën e dëmtuar në kontest të rregullt civil.

Andaj, gjykata duke u bazuar në dispozitat ligjore të nenit 358, 364, 449, 450 dhe 459 të KPPK-së, nga arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA ZUBIN POTOK

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.58/2022, datë 30.08.2024

Bashkpuntorja profesionale
Kaltrina Sfarqa

Gjyqtarja e vetme gjykuese
Marigona Lajqi

KËSHILË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar e drejta në ankesë në afat prej 30 (tridhjetë) ditë, nga dita e pranimit të aktgjykimit me shkrim. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet kësaj gjykate në kopje të mjaftueshme për gjykatën dhe palët.